



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/Nr. 1194/2018
Data: 09.02. 2018

PROCESVERBAL I KKSB-së

Nga mbledhja e parë - I- për vitin 2018 mbajtur me datë: 26.01.2018 me fillim pune në ora 14:00, prezent ishin: **Nuhi Dema** (Komandant i stacionit policor), **Vahid Hyseni** (Komandant i policisë kufitare –vija e gjelbër), **Isni Bushi** (përfaqësues i këshillit të prindërve), **Menduh Vlashi** (Drejtor për arsim, kulturë, rini dhe sport), **Refet Kalisi** (Drejtor për shërbime publike dhe emergjencë), **Amir Bushi** (përfaqësues nga zyra për barazi gjinore), **Isa Shkreta** (përfaqësues i E.V.S.B), **Nusret Shiti** (Administrator i Hanit të Elezit), **Qamil Kalisi** (Përfaqësues i Handikos).

Takimin e kryesoi kryetari i komunës z. **Rufki Suma**.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë mbi sigurinë në komunën e Hanit të Elezit.
3. Shqyrtimi i draft planit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2018.
4. Të ndryshme.

Rufki Suma pasi përshëndeti të pranishmit lexoi rendin e punës dhe pasi që nga të pranishmit nuk pati vërejtje në rendin e punës, njëzëri u miratua rendi i punës.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Rufki Suma a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.

2. Informatë mbi sigurinë në komunën e Hanit të Elezit.

Rufki Suma lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nuhi Dema:- sa i përket muajit Janar ka qenë muaj i qetë, gjendja e sigurisë ka qenë në nivel të duhur. Kemi të raportuara vetëm 4 raste, ku një prej tyre është ngacmim, dy lëndime trupore dhe një rast vjedhje në fshatin Gorancë.

Vahid Hyseni:- gjatë këtij muaji në vijën e gjelbër kemi pasur 9 raste, ku prej tyre 5 kalime ilegale, 1 kalim ilegal me armëmbajtje pa leje, 1 kontrabandë e prerjes së drunjtve. Te kalimi ilegal me armë mbajtje pa leje i kemi kapur dy të mitur ku gjatë bastisjes kemi hasur në dy revole, ku njëri prej tyre ka qenë i kërkuar me urdhër arrest prej gjykatës së Gjilanit për disa vepra, është dërguar drejt stacionit policor të Vitisë, për tu përcjell për gjykatë.

Amir Bushi:- te ngacmimi desha me ditë çfarë ngacmimi ka qenë.

Nuhi Dema:- sa i përket ngacmimit ka qenë një mos marrëveshje mes fqinjëve.

Nusret Shiti:- pak më herët fola me dikë dhe ai më tregoi se nëpër shkolla po përdoret një lloj bari dhe më tregoi se vijnë disa persona nga Kaçaniku dhe e shesin këtu tek ne.

Nuhi Dema:- sa i përket këtij procesi ne kemi një plan të veprimit “Stop drogave nëpër shkolla” i cili ka filluar prej muajit Shtator, ku kemi mbajtur ligjërata dhe kontakte të vazhdueshme me menaxherët e shkollave, lidhur me këtë deri tash nuk kemi pasur ndonjë informatë. Kisha lutur ata persona që pak dinë diçka të drejtohen tek ne, jemi të përkushtuar për ndihmë në këtë drejtim.

Rufki Suma te puna e shkollave është mirë të bëhen kontrole të befasishme pa ditur askush lidhur me këtë.

Isni Bushi:- kemi pasur takime të shpeshta lidhur me këtë dukuri (përdorim të drogës) sepse po qarkullohet me të madhe se është duke u përdorur droga nëpër shkolla, mirëpo ende emra konkret nuk kemi nuk është kap dikush që është duke shitur apo përdorur mjete të tilla të dyshimta.

Menduh Vlashi:- sa i përket kësaj çështje është mirë me u cek me emra kush, kujë i ka thënë, pastaj është mirë të kontrollohen edhe shitoret sepse po shiten cigare me copa.

3. Shqyrtimi i draft planit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Rufki Suma:- te shqyrtimi i draft planit të KKSB-së për vitin 2018, realisht ky draft miratohet rregullisht në kuvend, ku gati për çdo vit janë të njëjta dhe janë planet e KKSB-së. Të gjitha pikat që gjenden në draft plan i kemi përmendur rregullisht.

Te puna e zebrave është e nevojshme me u bërë por është edhe problemi i Bechtel-Enka-së, pastaj te pika kufitare është mirë të merret masa diçka për arsye të kolonës që po bëhet dhe po pa mundësohet banorëve të fshatrave Seçishtë, Krivenik , Goranc për kalim.

Lidhur me draft planin e KKSB-së a keni diçka me shtua nëse jo e hedh në votim dhe u miratua pa ndryshime të përcillet për kuvend.

Nusret Shiti:- kam bërë kërkesë që të bëhet presion për pastrimin e rrugës sepse është duke u bërë në gjendje shumë të keqe nga punimet e Bechtel-Enka.

4. Të ndryshme.

Rufki Suma:-te problemi i qenve endacak i cili asnjë herë nuk është zgjedhur, ku në qendër arsyetohen se janë ndarë mjete financiare në vlerë prej 1,300.000 euro i cili do e zgjidh problemin e qenve endacak. Te KEDS-i javën që shkoi kemi pasur shumë probleme, unë e kam thirr drejtorin e përgjithshëm në takim dhe prej asaj dite nuk është ndalur.

Refet Kalisi:- te kërkesa e pastrimit të rrugëve është e pa mundur të realizohet sepse është duke u punuar shumë dhe nuk ka mundësi.

Mbledhja përfundoi në ora 14: 50 ju faleminderit për pjesëmarrje.

Procesmbajtësi
Irfan Suma



Kryetari i Komunës
Rufki Suma

